

Ahmet Kot

# Uthullëra dhe ujëra





© LOGOS - A  
2 0 0 6



S H K U P  
PRISHTINË  
TIRANË



Ahmet Kot

# Uthullëra dhe ujëra



Poezi



Është e ndaluar të shpërndahet, të kopjohet, të riprodhohet, të përdoret në mënyrë komerciale dhe për promovim pa lejen e autorit të drejtë të autorit. Për informata më shumë, kontaktoni me: Logos, rr. "Dëshmorët e Kosovës" 110, Prishtinë, Kosovë. Tel: +383 45 211 111. E-mail: info@logos.com



E shqipëroi nga origjinali:  
Dr. Mithat Haxha

Titulli i origjinalit:  
Ahmet Kot: Sirkeler ve Sular  
Yazı Yayıncılık, İstanbul, 1988

Ahmet Kot



# Uthullëra dhe ujëra

Poezi



**AHMET KOT**

**UTHULLËRA DHE WËRA**  
pësi

Baton, Logo-A  
Biblioteka, Divan

Për botuesin: **Adnan Ismaili**  
Kryeredaktori: **Rusamedin Abazi**  
Redaktor i bibliotekës: **Dr. Milazim Krasniqi**


Redaktor artistik & dizajni: **Edi Azagjryshi**  
Redaktor teknik: **Albin Gashi**

Mbledhja & shtypja: **Imër Gogjafi**  
Përgatitja kompjuterike: **Focus Pro - Shtyp**  
Shtypja: **Focus - Shtyp**

Copyright © Logo-A, 2005

Shtëmi i CIP katalogut i kësaj libri gjendet  
në Bibliotekën Kombëtare Universitare  
ISBN 9989-58-193-1

[www.logo-a.com](http://www.logo-a.com)



Ahmet Kot: **UTHULLERA DHE UJERA** – *poezi*

Titulli i origjinalit turqisht  
Ahmet Kot: Sirkeler ve Sular

E shqipëroi nga origjinali  
Dr. Mithat Hoxha

Stamboll, 2006











## Përmbajtja:

Poeti Ahmet Kot dhe poezia e tij .....	6
<u>Poezi që shenjon dimensionin hyjnor të kohës e të ekzistencës</u>	
njerëzore.....	9
<u>Uthullëra dhe ujëra .....</u>	16
Dritës sime.....	18
<u>Kalim në një tjetër kohë.....</u>	20
Kalim në një tjetër kohë.....	22
Pa shih, pranvera po na vjen!.....	24
Jeta më mblidhet mbi supë.....	26
Uthullëra dhe ujëra .....	28
Ditë pushtimi .....	30
Deti i afruar pranë detit.....	32
Goditje.....	36
Përshkrim tërmeti në bark të xhindit.....	38
<u>Kërkime pushke.....</u>	42
Trëndafili transparent .....	44
Kubeja jonë, arkitekturë vezulluese .....	46
Dyzet gonxhe prej atij që iu bashkua Zotit .....	47
Jehona e lindjes së diellit mëngjesor.....	48
Trëndafili poetike.....	50
Turist poetik .....	52
Kërkime pushke.....	53
Hapës .....	54
Pritje pranvere .....	55
Ulok.....	56
Karafil i argjendtë.....	57
Qafëpërkulur.....	59

<u>Saze!</u> .....	<u>60</u>
<u>Të pafrikë</u> .....	<u>61</u>
<u>Mbi kudhren time ulen zogj e rrinë</u> .....	<u>64</u>
<u>Poezi - kushtim</u> .....	<u>66</u>
<u>Shtatënjakeri</u> .....	<u>67</u>
<u>Mbi kudhrën time ulen zogj e rrinë</u> .....	<u>68</u>
<u>Ka për t'u shturur</u> .....	<u>69</u>
<u>Njerëz - ushtarë</u> .....	<u>70</u>
<u>Vendimet e nëntorit</u> .....	<u>71</u>
<u>Fytyra e përskuqur e shtatorit</u> .....	<u>72</u>
<u>Burbuqe sevdaje</u> .....	<u>74</u>
<u>Duke përmendur ujin</u> .....	<u>76</u>



# Poeti Ahmet Kot dhe poezia e tij

## Shënime

Ahmet Kot lindi në qytetin Eskişehir të Turqisë në vitin 1953. Po aty e kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Studioi në Fakultetin e Shkencave Administrative ODTÜ (Universiteti Teknik i Lindjes së Mesme). Pastaj e mbaroi Degën e Sociologjisë të Fakultetit të Letërsisë të Universitetit të Stambollit. Punoi si nëpunës në ministritë e kulturës dhe bujqësisë si dhe në Studion e Stambollit të TRT (Televizionit Shtetëror të Turqisë). Pastaj e la nëpunësinë dhe punoi si gazetar në organe të ndryshme të shtypit brenda e jashtë vendit. Ishte ndër themeluesit e Shtëpisë Botuese “Yeryüzü Yayınları” ku punoi si drejtues botimesh. Nga viti 1985 e këtej punon si përfaqësues i shtypit të huaj. Ahmet Kot është edhe themelues i agjencisë “Yazıevi İletişim Hizmetleri”. Është i martuar dhe ka tre fëmijë.

Poezitë dhe veprat e tjera letrare i ka botuar në revistat Hareket, Deneme, Gelişme, Diriliş, Edebiyat dhe Maveria. Ka botuar shkrime në revista dhe gazeta të vendit e të huaja.



Libri “Sirkeler ve Sular” (Uthullëra dhe ujëra) është vëllimi poetik kryesor i poetit. Siç kuptohet nga titulli, gjithë vëllimi përshkohet nga një linjë ideore kundërvënijeje mes uthullërave dhe ujërave me të cilat ai simbolizon në mënyrë përgjithësuese dy ide, dy botë, dy cilësi, dy këndvështrime, dy synime, etj. po aq të ndryshme nga njëra-tjetra sa ç’janë të ndryshme nga njëra-tjetra uthullërat me ujërat.

Për ta realizuar artistikisht këtë linjë kundërvënijeje, autori përdor një simbolikë të thellë dhe shpesh të tillë saqë mund të thuhet se bie në simbolizëm. Pikërisht për këtë arsye përpjekja për ta zbërthyer nga ana ideore dhe artistike poezinë e tij ose, thënë ndryshe, për ta interpretuar atë, jo vetëm do t’u hapte rrugë interpretimeve eventualisht të gabuara, por edhe do t’ia zbehte bukurinë dhe shijen veprës, sidomos në shkrime të tilla të shkurtra me karakter njohës. Në kontekstin e poezisë bashkëkohore botërore, ku simbolika është bërë karakteristike e shprehjes letrare, kuptimi i poezisë së këtij poeti nuk do të jetë i vështirë. Fundja, edhe nëse me vargjet dhe poezitë e veta poeti ka dashur të japë një mesazh, këtë ka dashur ta bëjë në mënyrë jo të hapur e të drejtpërdrejtë, por të mbyllur e të tërthortë. Këtu qëndron edhe bukuria artistike e poetikës së tij me aq sa ka arritur ai.

Në më të shumtën e rasteve, autori shprehet me anë të simboleve, antitezave, similitudave, asociacioneve dhe epiteteve. Disa herë ose shpesh herë, figura artistike e përdorur prej tij del jashtë standarteve logjike, epitetet dhe metaforat duken të panatyrshme e të pakuptueshme. Si gjuhë, poeti përdor një turqishte, në mund të

shprehemi, të kulluar. Ai përdor shumë fjalë të rralla, shumë nga të cilat nuk gjenden as në fjalorët shpjegues më të pasur të turqishtes, ndërton vetë fjalë dhe kuptime të reja nga brumi i turqishtes. Siç ndodh sot në poezinë turke, në shumë poezi ai nuk përdor asnjë shenjë pikësimi.

Poezia e poetit A. Kot është e ndërtuar me varg të lirë pa iu nënshtruar rregullave të metrikës për sa u përket numrit të rrokjeve dhe rimës. Megjithëkëtë, ai e përdor gjerësisht rimën dhe asonancën dhe poezia e tij është e rrjedhshme dhe tingëlluese në sajë të elementëve poetikë që përmendëm më sipër si dhe aliteracionit të tingujve që po e theksojmë këtu.

Besojmë se shumë nga cilësitë dhe karakteristikat e poezisë së A. Kot janë përçarur edhe në shqip, kështu që lexuesi shqipfolës edhe do të mund t'i kuptojë këto që u thanë shkurt gjer këtu, edhe do të mund ta kuptojë dhe shijojë të veçantën e bukurisë së kësaj poezie siç është në turqisht.

*Shqipëruesi*





## Poezi që shenjon dimensionin hyjnor të kohës e të ekzistencës njerëzore

Poezia e vëllimit “Uthulla dhe ujëra” e poetit Ahmet Kot shtron një dilemë themelore të njeriut, njohjen e kohës dhe të fatit njerëzor brenda saj. Shenjimi i toponimeve me ngarkesë kuptimore historike (Bizanti, Stambolli, Mesdheu), si dhe i gjendjeve emocionale, fizike e shpirtërore të subjektit poetik, të alternuara me gjendje të nuancuara stinësh e bimësish, janë në funksion të kësaj njohjeje, e cila nuk është e mundshme nëse nuk kuptohet dimensionin hyjnor i saj. Por, nëse kjo kuptohet (Një mijë katastrofat që jetoi njerëzimi, / sikur një çast i vetëm qenë) atëherë edhe koha merr kuptim dhe bëhet korniza e ekzistencës së njeriut (Mëshira, gjithësinë me një sexhde duke e tronditur...).

Adresimi i Mëshirës që e trondit gjithësinë me një sexhde, e bën këtë koncept poetik shumë të fuqishëm, sepse e nxjerrë nga klisheja e njohur humanistike, ku koha dhe gjithësia e njeriu brenda tyre, trajtohen në mënyrë vulgare, si esencë në vete, me çka ato janë të zhveshura nga kuptimi i tyre i vërtetë.

Mjeti njohës dhe vlerësues me të cilin poeti Ahmet Kot e observon kohën dhe ekzistencën njerëzore, me fshehtësitë e saj, është poezia. Metafora “porta e poezisë” sugjeron depërtimin nëpër pengesat e blasfemive, ndërsa më tej poezia rezulton si një krijesë që nuk ka

frikë e rrjedhimisht është mjeti që ndihmon në përpjekje për ta njohur fshehtësinë e ekzistencës:

Dita ditës i shton ditë...  
Gjethja dridhet tërë frikë  
Kur nga qielli i kthen sytë,  
Poezi, ti nuk ke frikë!..

Në përpjekjet e zbërthimit të enigmave të jetës e të historisë, poeti Ahmet Kot ka tematizuar edhe disa aspekte të së kaluarës, ku Stambolli vetëtin si një dhimbje e poetit për degradimin dhe rrezikun e shkëputjes nga e vërteta:

Frymën e fundit je duke e dhënë, Stamboll,  
Fjala jote e Dëshmisë ku është?

Këto janë ide të skicuara, ndoshta të kamufluara, por që e kanë mprehtësinë e tyre prej një arti poetik të pastër e larg nga ideologjia agresive.

Poezia e Ahmet Kotit, edhe kur është miniaturale, në formë të proverbave poetike, sikundër janë miniaturat e titulluara “Të pafrikë”, “Burbuqe sevdaje” dhe cikli “Duke pritur ujin”, e ruan konceptimin poetik dhe figurshmërinë mbresëlënëse.

Rrjedhimisht, botimi i këtij vëllimi poetik në shqip, pa dyshim që ka një vlerë të konsiderueshme për njohjen e vlerave poetike të këtij autori dhe të një ndjeshmërie që pulson në poezinë moderne turke, por e cila nuk njihet sa duhet ndër ne.

*Dr. Milazim Krasniqi*



# Uthullëra dhe ujëra



## Dritës sime

Një mijë katastrofat që jetoj njerëzimi,  
sikur një çast i vetëm qenë;  
një fjalë ra në ujë me një llapaçitje të papritur,  
një zemërim i paparë i bymyer duke vluar brenda  
vetes tonë,  
bulëza-bulëza ra mbi një lumë në shtratin e vet, i  
nemitur...

Kështu, pse ndoshta për hakmarrje jemi prerë...

Ujërat, me një frikë të panjohur u drodhën,  
dherat, me një shikim të hollë u ndriçuan;  
një epokë nazike që, mes epokash duke u veçuar,  
një bisturi jetëdhënëse, mendjen mespërmas duke  
na e çarë...

Prej thellësisë, zemra më brof drejt një dritës sime;  
mos vallë një hanxhar rrezesh pret? S'di pse

zembrës së tokës së harbuar i ra zjarr;  
qiej e ujëra, prej përdhunshmërisë u qëruan,  
fisi im, zemërplasar për një dritë të pashpresuar,  
Mëshira, gjithësinë me një sexhde duke e tronditur...





# **Kalim në një tjetër kohë**



## Kalim në një tjetër kohë

E dashura ime e shtrenjtë, mos shko,  
në këtë natë të bujshme të qajmë e të rrimë!..  
Në gjakun tonë, fjalë të ndaluara plasin, fjalë miqsh  
na presin, si një zog freskie të pafund në gjoksin  
tonë  
dhe një jetë e nxituar zgjatet e shkon  
n'sa karvani ynë i mjerë, i pazë, i pastoli,  
miliona të pafjalë  
brenda trëndafilin vijë vërdallë...  
Koha qiejt i shumon...  
O kohë e pabrinjë që zë borë,  
o kohë-hauz që nxjerr në breg kalorës e shëmtirë,  
sa e sa kalime ke bërë;  
një tjetër gjendje, hyrje për një tjetër periudhë...

Ti, një vend me mendjen që nuk njih tërmet,  
nata jote e hallakatur,  
nga faqet e së cilës buron buzëqeshje, nxin;  
kalojnë njerëzit me ballet si një shtet;  
njerëzit kalojnë: janë për një kohë të caktuar,  
të kurdisur për një orë, për mëngjesin në të aguar...  
Dhe duhet ta dish këtë! Në mos e ditsh,  
nata jote-parandjenjë ka për të të nxirë;  
o ti, vend me mendjen që nuk njih tërmet,  
sa të jesh gjallë, zërin më s'kanë për të ta ndjerë  
sepse kutitë-krim të ngrehinave,

të ngrehinave me të biruarat sytë,  
ato kultura-xhelatë,  
hirërat qytetërimore që nga thellësitë,  
ngrehinat fjalëbukur, por symbrapshhtë,  
janë mburojë e rënë në lumë,  
orë e shkrirë me piskamë,  
korie me qumësht e helm,  
një zvarranik që hesht papritur janë...

O vrull i vjetër, vrull i vjetër,  
njeriu yt kështu u bë njeri;  
vdekjet e tua, degë-degë në të gjelbër...

Mëshiruesi një fjalë hodhi përmbi ditë e natë,  
një fjalë që i përshkon qenien e dhimbjen ijë më ijë:  
fjalën që thonë "Bujari";  
ç'apoteoza korale nëpër natë u lartësuan!  
Zhubra-zhubra e zhubrosi gjakun  
dhe jeta mori vrull nga galeritë

e më pas qiellin  
një tufë shqipesh fatmiroshe e mbuluan!

## Pa shih, pranvera po na vjen!

S'di si rri e rri e ma pranonte mendja  
frikën tonë me atë ngarkesën e saj  
në formë furtunash shqote të zemëruara...

Ju, o frikëra që na lëshoheni sipër,  
cilat çmenduri të qena jeni  
që ne ju arritëm duke ju ushqyer si një mbeturinë  
nga fiset e mëdha të Mesdheut,  
të Mesdheut të zogjve të kësaj pranvere  
habidhënëse, përvëluese,  
të fluturimeve të tyre që djall prodhojnë  
e djall konsumojnë...

Po këta,  
si i bënë këta rishmë të jeshilojnë  
të vdekurit-kuaj të nxitur për t'u hakërryer,  
të jeshilojnë zemrën  
të shkruar në atë trungun kërkëllitës të marsit,  
të shkruar çdo ditë,  
mijëra ditë, disa herë në ditë?

O poezi-pyll,  
pse në pranverë më e papërcaktuar je se një rrugë  
dhish në emër të shkëlqimit të mospranimi të së  
mundshmes?

Si ndodhi që,  
pasi na bënë të presim me vite,  
macet verdhacuke e me trup të dridhur  
të zbresin si një ciklon rrugëve tona  
duke na u lëshuar mbi jetën tonë  
kur ende nuk u kishim dhënë ujë trupave të tyre të  
qytetëruar,  
të zbresin në formë prove vetëvrasjeje para nesh  
kur pranvera ende nuk na i pat përzier në damarë  
ditët dhe netët tona blasfemike?

Mëngjesi që në këtë ditë rinore e të bukur  
vjen e na shtrohet në shpirt  
në trajtën e një pele manekine,  
figurina përgatit për atë blunë ujëvrasëse,  
për atë blunë e përhapur gjithandej, ku rri,  
figurina gjethesh pjellore  
që, të gjetura në sofrat e tokës,  
do të lëshohen mbi qytetet,  
si një mëshirë begatidhënëse do të lëshohen  
në shtratin mitror të maleve e fushave...

Pranvera vjen,  
qoftë edhe një çast pa u vonuar;  
pa shih, pranvera vjen  
me vrap, para duke çarë  
me tërë qëllimin e saj të mirë!..

## Jeta më mblidhet mbi supe

Unë jam njeri,  
Një qenie që mbledh një jetë të fshehtë mbi supe,

Me sytë ngjitur me терминаlet lajmdhënëse të qiellit  
Ose që lodhet në ngatërresat e rastësishme,  
Një botë që kalon nëpër labirinte insektesh  
Fërfëritëse, merimangash  
Që janë nga një ndriçim qelqor më vete,  
Jo prej bisede me malin, por prej argjile të ujshme...  
O mendje, o zog që fre i jetës je,  
O ju mendje-zogj, ngrehuni, një tërmet radhit lumi  
Për ato rrjedha yjësie dhuntish pa theqafje,  
Për rrjedhat, терминаlet lajmdhënëse të qiellit.

Njerëzit që në libra përmenden si gjeografi vdekjeje,  
Me krenari e mendjemadhësi – çanta mëkatesh mbi  
supe,  
Krijesa imorale nëpër autobuze,  
Me sytë të gërryer prej letre dhe objektivi  
Nga një gjë e porsambirë e larë me borë dhe e  
tharë,  
Krijesa që pikojnë si fëmijët në jetë pikë pas pike,  
Në pëllëmbët, yjësi dhuntish, gjurmë përpjekjeje...

Ujëvarë njëvargshe është  
Bora e hedhur mbi fytyrë të tokës sime,

Kurse poezia, një përrua që bulëron e avullon,  
Një gëzim tërë gjemba, por i ngrohtë...  
Egjër i pluhurosur i një vjeshte që nxjerr demonë  
Në të katër skajet, që dhe poetët i nxeh e i tërbon  
Jemi ne, jemi unë, ti dhe ajo princesha e zymtë e  
poezisë;  
Fëmija mijëvjeçar i detrave fisi ynë.

Ç'shpatë poezie ajo që jua ka bërë zemra,  
Prisni një fjalë ta mbështjellim mbi trupin tonë  
mijëravjeçar.

Ndërkaq, sytë m'u tronditën nga mahnitja  
Për ata udhëtarë,  
Nata ime faq'e qiellit m'u bë me fletë nga dashuria,  
Zemra m'u bë me fletë.

Njeri jam unë, ai që i mblidhet mbi supe jetë e  
fshehtë...



## Uthullëra dhe ujëra

Pa shih, një periudhë historike para teje udhë po merr;  
duke u rrudhur e shpalosur  
drejt shesheve të qytetit dhe zemrës së natës,  
një histori po merr udhë e mbushur plot tmerr...

Çdo çast i natës,  
me një mëndjemadhësi të zbehtë mbi supet,  
është kah dridhet e lëkundet prej frikës së ndjerë:  
buzëmbremja, për një mijë drithërima tmerrri është  
një derë...  
(njeriu në errësirë e zgjidh veten;  
errësira, për qiellin, përmendore për lavdi e nder...)

Enigmën e vet, me kalema të çeliktë nëpër zemrën  
time  
prej gjaku dhe kozmosi duke përshkuar

e zgjidh një div ngjyrë nafte  
me një gjuhë të flaktë, thellë e thellë;

qiellit të cektë i shtron shtresë mëkatesh,  
rrëzohen prej mjerimi yjet e mjerë...

një dyshim merr udhë për të ardhmen,  
një frikë e tmerrshme thellë e thellë...

\* \* \*

Sigurisht, vjen një ditë e,  
ndërsa qiriu me sytë tejet të verdhë  
sheh për diamant duke e kujtuar  
errësirën që flakë ka marrë;  
ndërsa uthullërat me ujërat  
me një uturimë apokaliptike vend duke ndërruar;  
me gëzimin dhe kënaqësinë e tyre  
shekujt-robër brenda meje  
duke vrapuar e u gjallëruar  
hapen drejt durimit tim duke u drejtuar,

një princ i ndyrë e neveritshëm i shëmtuar  
tërmet u sjell urave të mia  
si rrufe nëpër qiellin blu duke u përshkuar...

Vjen një ditë e ndodh një ndryshim;  
vdekjen e mosbesimit dhe revoltës në pyjet e çeliktë  
duke përhapur e kujtuar,  
sytë e krenarisë gërryhen:  
as një rezistencë, as dhe një kundërshtim,  
përnjëherë flaka e ditëve të mia meket në të shuar.

## Ditë pushtimi

Ishte një vend borërash të shpejta,  
Ishim bashkë në portën tënde ato ditë;  
Ishte një makth i mbrapshtë,  
I pandërprerë vajtimi yt!

Një jehonë të kishte bërë në zemër zemra,  
Një shkëlqim si ai!  
U përgjunja, në tokë ballin shtriva,  
Kor dëbore vajtimi yt!

Bashkoje zemrën, lidhi duart,  
Stolis e zbukuro!  
Finale madhështore  
Eshtë vajtimi yt!

Vendi im, vendi im,  
Shpirt e frymë vendi im,  
Rrjedha e jetës ku është?  
Ku është vajtimi yt?

Në pata rënë nën pushtime  
Me ty, o zemra ime,  
Vlente mjaft sa për ty,  
Sa dita, sa dielli,  
Sa shumë hidhërime  
vlente vajtimi yt!

Fotoja e kohës tënde të pranverës, ja  
Ishte aq e pakohë dje,  
Ç'pushtim i hidhur ishte ai,  
Zemra edhe pa ty u zbraz atje.

Po porta e poezisë?  
Kishte lloze blesfemie  
Apo një provë prapë:  
U hap apo s'u hap!

## Deti i afruar pranë detit

### Udhëtimi im në Bizant

Me një radhë plagësh të imta dje mbrëmë e sfidova  
Gjoksin e detit, thirrjen e tij rituale si klithma  
E mekur e një qeni cofëtirë;  
Por kush është deti e kush jam unë, a i marrë!

Thashë:

A s'rrëqethem unë sa herë që kalon një tank  
sovjetik?

Ja lëmshi prej mbeturinash të mprehta e të  
përdredhura

Të tepruara nga peshku që hëngri e hëngri  
E e la përgjysmë tregtari bizantin!

Të tilla edhe ujësjellësit dhe cisternat e sajuara  
Në gjoks të qytetit, të përdredhura;  
Uji i lënë përgjysmë ndërsa po pihej në një rënë  
Prej ditëve shumë të dhimbshme por komike,  
Në duar të ordinancës bizantin!

Thashë, pra:

A e kuptoni se ç'zog jam unë?  
Ka ditë që s'kam asnjë ndryshim prej teje,  
O det, prej teje, pra!  
Një trumcak që ka qëndruar mbi një shegë  
Me kokrrat të rëna, të numëruara, në bahçen tonë  
Duke bartur një pjekuri për të ardhmen tonë.

Shih, shpirti të tronditet; ujërat e vjetëruara  
Vetëm për ty eulogji, sepse egoja jote e ndryshkur  
brenda  
Qëndron me krenari,  
Me një qëndrim trafiku të çastit që ma pret çdo  
udhëtim!

Thashë, ja, po të pyes ty:  
Ç'lloj fluturimi jam unë për në tokë,  
Për në këtë tokë tribu shenjtorësh me tërë atë  
histori  
Ku truri i njomë i vdekjes bën të blerojë kodër e  
mal?

Më parë, një udhë dhish, pastaj një urë  
Me një mijë shkallare të ngritur në këmbë;  
Pse gëzohet kështu deti? Nga fyerja e Bizantit  
Apo çirakllëku i tij? Tamam, ky, pra, është  
Fundi i mureve të atij kryeqyteti që vijnë përqark!

Heshta. Është vetëm fryma jote  
Ajo që ma hap zemrën për në tërmete; je ende një  
Bizant  
Ti, që na je ngulur brenda si një thikë me Bririn e  
Artë;  
Ti je ai deti i vjetër, por edhe unë, me miqësitë e  
mia,

Jam udhëtari yt në hapësirat e tua!

## Udhëtimi im në Stamboll

Sytë e mi, mburojë e një deti të kripur,  
Pas meje, tërë një Topkapi;  
Në kurriz, plaga e shigjetës së atyre viteve  
pesëdhjetë,  
Pranë meje, një karikaturist i kënaqur  
Që e sheh shkumbën që lë pas gjemia, me habi...

Pashë: kaq shumë rrugaçë, zeqat i kapitalit duhet të  
jenë;

Pashë: Në mjedisin tim të detit rrinë  
Gallata, tumor; Sulejmania, krenari;  
Çështja është se si e kërcënojnë avullin që arrin  
Në të gjitha skelat në Gji!

Nga shehulislamët, pranë gjunjëve fisnikë të të  
cilëve

U afrova e qava, këndohen fletë të freskëta  
Të përbëra prej pushit të një trëndafili fletë-fletë;  
Hafizët u lëshojnë një flad të kadifenjtë  
Skelave të vogla prej trapesh - të qelqtë.

Pashë: Një fëmijë inxhinier i thellë,  
Si i lëshuar pas teje;  
Një këndes si i lëshuar pas zërit të vet,  
I zgjuar ndaj qiellit tënd i tendosur ka qindra vjet,  
Në prak të zbardhjes, i kushtuar teje...

Kohët e tua, një mësim i çmuar,  
Rreth e rreth me mesnevi çarkuar;  
Ç'thoni, a ta shumëfishoni në zemrën tonë  
Detin nga mëlçitë copë-copë të buzëve,  
O shenjtorë radhë-radhë, mos na harroni ne!

Pashë: Si një e metë më shumëfishohet në ballë  
Një bardhësi fetare,  
Si një re pakësimi më afrohet shëtitjeve, hobeve;  
Mbrëmja, rrebesh ikjesh nën mungesën e dritave  
Që e tendosin detin.

Të qetët, gjuhët e etura dhe treni i mallrave  
Dhe deti i afruar pranë detit,  
Në je i dendur, me këto flutura i dendur je;  
Sklevërit e tu besnikë jemi të gjithë ne;

Pasioni copë-copë vjen e mbi trup të rri  
Edhe nëse nuk e ndjen!

S'e di në e pashë a s'e pashë,  
Por që nuk u dallgëzove, e pashë;  
Krejt i rrafshhtë ishe, diturisht u hape,  
Ky fillimi a fundi yt ku është?  
Frymën e fundit je duke e dhënë, Stamboll,  
Fjala jote e Dëshmisë ku është?



## Goditje

### Kujtimit të shtrenjtë të Fethi Gemuhlluoglluit

Nga korniza e një mbrëmjeje të thellë  
qytetin sodita,  
u vura veshin zërave  
dhe një goditje prita...

Mirëpo pashë se u kthye qetësia;  
qetësia nuk është goditje,  
nuk është zjarr i shtruar nga dielli para portës sonë

Por qime-qime mundësisht i lexueshëm një at,  
ora që e rrethova çast për çast...

Po frika  
e ardhur me uturimë nga labirintet  
e zogjve të qytetëruar,  
frika e grumbulluar në zemër prej udhëtimeve  
në këtë orë pasi me uturimë ju ka ardhur në portë e  
gjunjëzuar  
ç'është?  
Ç'janë zemrat,

shëtitjet, ç'janë?  
Një faqe e hapur kat më kat,  
shko e shko e e parandjerë  
prej beqarëve të dashurive  
këto martesë, vdekje në moshë të re?

Ti tashmë një hije je,  
eja,  
mblidhe pasurinë e bukës tënde,  
gruan dhe fëmijët mblidhi  
e këto nguli fort në mend,  
se, kur të vijë goditja,  
kanë për t'u pyetur  
orët që konsumove si krimb duke i brejtur,  
fjalët nga mali në mal duke i përhapur...

Nga korniza e një sofër të thellë  
të mirat shtohen e radhiten:  
një shikim i imtë janë,  
i ndiejnë  
gjurmët e materies që na ngjiten sipër  
pandërprerë...

Ç'është kjo, kjo çezmë e freskët, kjo hënëz e brishtë  
që më troket në derë?  
Një nismë astrologjie, thonë librat;  
një goditje qielli të heshtur ka pësuar,  
djallin e dhënë dhuratë ka takuar  
thonë  
të diturit, burrat e moshuar...

## **Përshkrim tërmeti në bark të xhindit**

### **Mali flet, tërmeti dëgjon; Në fillim vdesin të mëdhenjtë...**

Kujto se si dje ai fëmijë i bukur fisi,  
Në hartat turistike të lira e të shkëlqyera  
Që i sajoi vetë për ditë të tëra me sytë pulitur  
përmbi to,  
I gjeti qytetet, i nxori nga xhepi pa i lënë mangët  
Njerëzit, zogjtë, detet dhe malet...

Sepse mali është ana më e qetë e njeriut,  
Një zog antene të tendosur e pa nyje, por edhe të  
pazë...  
Një Israfil bart kopshti-mrekulli në zemër të tij,  
Sepse Israfil është fragmenti më pa fotografi i malit  
Dhe thuhet se shfaqja e periudhës  
Që do ta hapë rezistencën me shkëmbenj dhe do ta  
ushqejë,  
Eshtë afër...

A ai që është ngjitur pas mushkërive metalike të  
Amerikës  
E rri,  
Eshtë më i freskët e i ri,  
Apo malet e Azisë?  
Mua po të më pyesni,  
Unë do të desha të thoshja të Azisë!  
Sepse brenda trenave shohin ata kur trenat kalojnë  
Ose shohin brenda Evropave në prag të  
qytetërimeve;  
Ata, domethënë, malet,  
Të gatuar me gjakun e një trëndafili, prapësohen...  
Patrulla vetullngrysur janë në botën tonë,  
Dëshpërimin dhe thellësinë kontrollojnë;  
Njeriut ferexhe i presin nga toka e rrumbullaktë,  
I presin koraca borë të bardhë,  
Shmangen nga bota.  
*Këtë herë mali flet por askush s'e dëgjon,  
Dhe, tani, s'ka kush që të thotë se fëmijët po vdesin*

Fundja, këta s'janë kufoma fëmijësh,  
Unë i njoh mirë fëmijët, i njoh mirë,  
Shumë qava pranë kufomave të tyre të njoma,  
Ta dini sa qava mes fetuseve, mes trupave  
Të ruajtur në formalinë...  
Fytyrat u mbeteshin si të qenë duke fluturuar  
Dhe ballet e mavijosur, një përshkrim kali,  
Përshkrim kali të prapë  
Jo në tregje e në sokakë,  
Por më tepër nga ai që ndodhet  
Në bark të xhindit...  
Kopetë e fëmijëve  
Që e përshkonin qytetin anembanë,  
Këta, barëra gjaku, sy shenjtorësh,

Vapë dreke,  
Gji freskie,  
Një ferr i kthjelltë  
Fatkeqësisjellës mali...

Pse, pastaj, një det me këmbë të rënda,  
Me anë të ndriçuara e reflektuese,  
Rënia e tij në gjunjët e mia me rrapëllimë,  
Thirrja e tij ritmike që shkon e vjen?

Gjurët, platforma vdekjeje të ngrohta,  
Tërmetin ia këndojnë shpirtit tonë që bëhet i marrë,  
Gurët, fragmente dëshmie, në i kuptojmë...

Në e kuptojmë, a s'është vdekja një copë guri?  
Në e kuptojmë, a s'është vdekja një copë nga ne?

Pastaj malet që janë një radhë e pjerrët pëllumbash  
Mbi fabrikë; dhe mbi pyej plot tufa derrash;  
Malet që janë që të gjithë rimëkëmbje bisturie  
Në duar të besimtarëve, në duart e tyre harta  
Të një rezistence të pagjak, të bardhë, të pastepur  
Në helmimet qytetërimore, malet, pra,  
Janë një shëtitje e grumbulluar  
Dhe e zbritur në qytet;  
Malet do t'i gëlltitin qytetet e do t'i pakësojnë...

Si zbardhen prapëseprapë shumë dije tona vjollcë,  
Shumë qoshe vdekjeprurëse, me një fjalën tënde,  
përnjëherë,  
Mali, tërmet, kurse fjala, prej teje një copë,  
Një copë fatkeqësisindjellëseje të rritur në rrëpirë,  
Zbret mbi qytet, pastaj

Në vdekje drurësh rrjedh tërmet,  
Në ngjallje njerëzish rrjedh tërmet;  
Goja jonë, një fjalë tërmet,  
Sa e sa tronditje i ngre në këmbë  
Në një mavijosje me një jetë të freskët;  
Nëse sytë dhe ankthet e maceve, qenve dhe  
lypsarëve  
Nuk përplasen në ndriçim, më besoni,  
Peshqit peshqngrënës, murtajë bashkëkohore,  
Turmat, murtajë përparimtare,  
Kurse mali, sipas tej e meje, i fundit stacion,  
Përtej tij, një kornizë e zbrazët në mendjen tonë!

Mirëpo fryma juaj kundërmon  
Ngaqë s'di ç'ka matanë;  
Mali, pra, frymën jua pastron,  
Mali jua pastron!

# Kërkime pushke





## Trëndafili transparent

Dritë e një trëndafili transparent e të zemëruar,  
Je kah hap dritaren me emrin vdekje për pranverën  
tonë;  
Dhé je, qiell blu janë për shpirtin tonë rastësitë e  
tua...

N'sa mbledhim xhufkat ngjyrëgështenjë nga  
gurishtet tona,  
Një sendërtim mermerit e ujit u ofron;  
Diell je dhe kthimet e tua me natën na i provon...

Në fyt, si një mollë e bakërt më përngjan,  
Toka dhe uji yt godasin gjallësinë e fisit tim;  
Vdekje je, ecuritë e tua, për të gjallët tim shpatë e  
sajuar janë...

Shpresë je;  
Atypëraty e godet tonën dritësi  
E prej syve antikë e dallëndysherorë të natyrës  
Gjallërohet me të gjithë qiejt nëna gjithësi;  
Kah pema marshojnë uji, dheu dhe kupa jonë  
qiellore  
Dhe pema me gjithë degë e mbushur plot gjak,  
Gjallëri u ofron pranverës, degëve të saj të vrara;  
Kur vjen ti dhe e përfshin malin tonë,  
Një gëzim është kah vjen e rrjedh mbi tokë;

Njeri je, në dhimbje e mbysin gjithësinë fjalët e tua...

Një trëndafil transparent je, vezullues e zemërak,  
Me dritaren-vdekje që na i bën buzët  
ta bërtasin fort gjallësinë...

Çdo goditja jote, një enigmë tjetër na e zbulon  
brenda vetes sonë

Dhe qindvjeçarët me flokët latinë të shpushpurisur  
I plas fjalët e tua-ciklon nëpër korridoret tona  
të nëndheshme,

Gjithësinë e plas torpidoja  
që na e rreh veten nga përbrenda,  
Në gjoks ndien hënën dhe çelikun i drithëruar...

Një shpend je q'i përplas krahët përmbi dhimbjen  
tonë

E, pastaj, drita e një trëndafili transparent e të  
amshuar...

## Kubeja jonë, arkitekturë vezulluese

Perçen time të tyltë të diellit  
Që përçohet prej kubesë-xham,  
Duart qiellore të Arkitekt Sinanit  
Qiell e ngrenë përmbi ne;  
Me një mijë krahë, një mijë e një kallfë  
Shkrime skalisin përmbi kube;  
Në duar një çekiç-bajloz,  
Plumb është kah rreh Mjeshtri Sinan!

Marmaraja blu është ajo që kullon  
Prej çezmës së Sinanit:  
Pema-popull e ujitur  
Dhimbje heq bashkë me ustanë;  
Fjalët e të mëdhenjve janë,  
Jo fajancë ajo që shtroi ai...  
Në dorë me një daltë të artë,  
Mermer po end Ustai Sinan!

Kush ia shtroi tullat?  
Një mijë shkallare, aventura një mijë;  
Mermerin e dhuruar të cilit shah  
Ballkoni i minareve mban?  
Selimija majëfloriri  
Shkronja argjendi shtron në qiell,  
Në të katër anët e shtetit Osman  
Ezan shtron Mjeshtri Sinan!..

## Dyzet gonxhe prej atij që iu bashkua Zotit

Mbrëmjen e verbër të bajramit, me zemrën të etur,  
Mori të ngrihet kas një dori i zëmëruar;  
Nga kulmet e jetës në mes të ndiesive blu të kulluar  
Dyzet gonxhe çelën; në shpërthim  
Nga sytë e të dyzetave ndriçim pat buruar...

Në zemrën tënde, o bir, thellësia blu e besimit;  
Qëllimit të tij kurrë, o dori, s'i dole kundër;  
Sihariq qe dalja jote të kthjelltave hapësira,  
Në dorën tënde drita - një plumb i paqëlluar,  
I rënë në tokë pas një fluturimi të shkurtër...

E vyshkura, o bir, lulja e revolucionit është; me të  
Edhe ty me një mijë ngashërime të zbresin në dhé;  
Vdekja, ftohtësinë lajmëron me zë të lartë, doriu  
dridhet;  
Vjen mëngjesi, çdo anë jona Det i Zi bëhet,  
Drit' e mbetur prej të bashkuarit me Zotin,  
përhapet mbi ne...

*(28 tetor 1973)*

## Jehona e lindjes së diellit mëngjesor

Përballë më lëkundet pritja e frikshme e ditës,  
Nga kandili përplasat në qiell guximi i papritur i natës;  
Përplas unë duart në natën tuaj e vjen një zë prej thellësisë...

Me çelësa të rinj vijnë çdo natë ustallarët e punëdores,  
Nga një përmendore tunxhi na e ngrenë brenda vetes,  
Pushteti u zgjatet gjer të vijnë çekiçët e artë të ditës...

Dhe sikur hanxhar të vihet natën në shtrat të shehzadësë,  
Gjithçka gropset nën tulla në mes të errësirave  
Sapo të ndihet laku trëndafilor i diellit në qafat tona...

Korniza e artë e ditës na i përfshin në çast nostalgjitë,  
Me kohë, entuziazëm pritet të na lëshojë mbi supe mëngjesi,  
Pritet bashkë me pëllumbat ai karafili fytyrë-flad mëngjesi...

Gjithmonë pritet serioziteti i natës  
Prej një mijë e një dyerve të qeta e të freskëta të  
qytetit.  
Entuziazmi i zverkgoditjes është duke iu ngjitur  
lart...

A nuk vjen, a nuk na godet ndriçimi përnjëherësh  
Në duart pasi të na i ketë mbushur me të ardhmen  
tonë?  
A s'më shkëlqejnë zemrës kornizat e arta të  
historisë?

Një hosten, një lumë, ujë diellor në grusht  
Portat e bakërta, e hekurta të hapen pres  
N'sa në fytyrë më bje jehona e lindjes diellore në  
çast...

Ja ku na ke! Na prit me kornizën tënde të  
përskuqur, o qiell!  
Shtrona para sofrën diellore, kripën natyrore,  
Lëshonae dritën e nga musllukët sinqeritet të  
rrjedhë!..

## Trëndafile poetike

*Nef'i (1572-1635) është mjeshtri më i madh i kasides në letërsinë e Divanit. Ka përjetuar periudhën e katër sulltanëve, por kulmin e pjekurisë poetike e të popullaritetit e pati arritur në kohën e sundimit të Muratit IV. Kryevepra e tij poetike është në turqisht, por ka edhe një përmbledhje poezish në persisht. Kurse poezitë satirike janë përmbledhur në vëllimin me titull "Sihâm-i Kazâ" (Shigjetat e Fatit). Për shkak të një poezie satirike shkruar për vezirin Bajram Pasha, është mbytur me lak dhe është hedhur në det.*

Me një fjalë plasëse nisi poezia;  
N'sa hapte krahët e hekurt drejt qiellit,  
Prej vitesh pati pyetur buzët e ndriçimit...

Në çdo atak të bandës ushtarake,  
Një këllëç të stolisur ngulte në zemër baketa  
Në vend të poezisë...

Prej mijëra shandanëve të kristaltë të shtetit  
Poezinë e alegorizuar pas kalit, një princ turk  
E merrte e e pëlciste përnjëherësh në zemër...

Ato poezitë marciale kushtuar Padishahut,  
Të poetit Nef'i që shkruante me këllëçin e vet me  
dy presa,  
Në një natë të vetme binin në kallëpin e satirës...

Nga thellësitë vijnë dhimbjet sublime  
Të poezisë që rron mbi maja këllëqesh  
Me t'na u çelur para syve trëndafilët e poetit turk...



## Turist poetik

Një t'iu dhënë zjarreve  
Sokakët pa dritë,  
Prej çezmës së sulltanëve  
Niset vjen një turist.

Jeniçerë përfyten rrugëve  
Në qytet si zakonisht;  
Nëpër tregjet e argjendarëve  
Seç përsillet një turist.

Pyetjet që pyet poezia  
Xham i bëhen një shtëpisë;  
Në konakët e përflakur  
Zgjatet, shtrihet një turist.

Seç ngre traun e hekurt  
Të sokakëve të dashurisë;  
Në hanz dhe qiell të bjerë,  
E nxjerr, e merr ky turist...

## Kërkime pushke

Muret nga brenda, një kërkim pushke;  
Pasi të provohet, pikon mbi krahët,  
Qafën dhe flokët e mi hekuri, kërkime pushke.

I varur në mur, po pret një hetim;  
Me t'u vajtuar, lëshohet mbi zemrat një hetim.

Eshtë çarë prej qëllimit, bashkëkohore një pushkë,  
Ngashërehet për teprimin, e përgjakur një pushkë.

Në mes të provimit, një fëmijë bashkëkohor,  
Domosdoshmëria jote mijëvjeçare, o kërkim  
pushke,  
Çdo gjë sikur e jotja, o kërkim pushke!

Mos u mërzit, bre, troftë duarlidhur,  
Një ditë ky mjedis në mermer ka për t'u kthyer!

Azia ikën, shkon; kthehet e vjen Azia;  
Sërish e puth dielli buzën q'i thonë Azia;  
Një atdhe je ti, kontinenti q'i thonë Azia!

## Hapës

Një hapës bakri të bukur kam në dorë:  
Dyer të hapura ndaj një të kuqes së zbehtë...  
Meqë i dituri mund t'u hapë udhë komenteve të  
reja,  
Zogjve të tyre diçka duhet t'u thuhet...

Në dorë, vijë; në xham, dielli;  
Në këngë njollë kompasit mbeti...  
Meqë, siç thonë, ra borë mbi gjithë hapësat,  
Mbretërit e mundur s'mund të vijnë me vrap...

## Pritje pranvere

Një shqelm hájni ndjen në ije papritmas:  
Fidanët e vjeçëm kanë mugulluar...  
Një grusht të kërcet në gjoks njëheras:  
Zemra prej pranverës të është arrestuar...

Drejt tokës një shi i rrëmbyer fillon,  
Pas një mijë vjetësh, natyra gjallëron;  
Përvidhet prej qiejve një shpend-epokë,  
Fluturimi yt qiellit i është shtuar!

Pema s'e bart dot vetëdijen e ndriçuar;  
Karvani tret një rrugë të pambaruar...  
Mal, fushë, lumë dhe pyll pranverën kanë uruar,  
Një natë tek turqit konak të kanë shtruar...

## Ulok

Një pemë, inkarnacion i njeriut është...  
Një shtambë uloke gjyshërit fytyrë-epokë  
Që tej nga largësitë zgjaten e vijnë...  
Ditar Pantenoni është libri Platon...

Ballkonet që ke parë nga sokakët,  
Ka vite që bahçeve të shtëpive uloke  
Tempuj majëmenekshe u mbetën  
Prej mbishkrimeve shumëfjalëshe antike...

Një trashëgim ulok sykataná  
Tragjeditë që lëshove në çaire;  
Të sotmes ofruar nga zotërit ceremonialë:  
Me jonianë e njohur, perëndeshë erotike...

## Karafil i argjendtë

Erzurumi, në dorën time një karafil  
me grushtin shtrënguar që s'ka frikë...  
Erzurumi në argjend ka qëndruar;  
përhapen ajazmave mijëra shkëlqime të tij,  
zemra, si një Erzurum për luftë është duke u  
forcuar...

Grushti i tj,  
qysh prej nëntëdhjetetreshit i mbetur,  
i moçmë një istikam,  
me një qëndrim të bakërt, i varur pret  
në mazgallat e çifteve tona  
bashkë me një urrejtje bashkëkohore;  
me t'u dallgëzuar në brendësitë e kohës,  
në të njëjtin çast me ty rrahin zemrat tona,  
zemrat tona që i japin ditës jetë...

Këllëç i nxjerrë nga milli më je, Erzurum;  
një poezi të gjatë në emrin tënd po filloj...  
çdo poezi kushtuar konstelacioneve të tua,  
epokave zgjatet pa mbarim...

Kur pëllumbat krahartë nga mazgallat e tua  
marrin fluturim,  
kur përhapen dallgë-dallgë në mes të qiellit,  
shumohen e shumohen e plasin diku;

mijëra fjalë që bartin,  
Marifetnamenë e kanë për burim...

Duhet të shpërthejë kuptimi yt pa u ndaluar,  
brenda vetes sonë  
përditë duke u rinuar...

Kur një dadash që rreh hekurin në Bedesten,  
e zbret bajlozin për vdekje mbi kudhër,  
nëpër tregje gjak kullon...

Ti, një karafil argjëndi je, Erzurum,  
përherë tërheqës, përherë i ri;  
pa shih:  
për ty e nisa,  
për ty po e mbyll këtë poezil..

## Qafëpërkulur

Një e qeshur prej atje  
është prej rrjedhës së sklevërve nga sokaku  
thneglat që pijnë ujë përdhe  
nata e errët me ca pllanga aty-këtu

mos është këngë kjo e përgjumur  
a Çaplini për ditët për t'u dhimbur

violina s'e përgjum Mozartin

nga liritë e errëta gjer më sot  
nacionalizëm i nemitur  
dhe në s'qoftë i lirë njeriu  
s'e bën dot të rrijë i heshtur



## Saze!

Gjersa të bëni shenjë në burime,  
U dogja për ju, saze;  
Si majë malesh me blerime,  
U dogja për zemrën tuaj, saze!

Shtambë balte-xhevahir në qofshi,  
Rtuazë inxhish në varg në qofshi,  
Meteor nomad në qofshi,  
Desha që t'ju shoh, saze!

Të pashpresit at i kuq n'iu bëfsha,  
Arë më arë përrua n'iu bëfsha,  
Kur vjen vjeshta, varr n'iu bëfsha,  
Në pranverë e hap një sy, saze!

Po Serdari a na kthen fjalë?  
I sëmuri a merr shpejt për mbarë?  
Po behari, a ka për t'ardhë?  
Pata shpresë, po vjen, saze!

## **Të pafrikë**

### **Plepi**

I blertë, i kuq, i verdhë në të hirtë...  
Kush je ti  
Që përbrënda më përsillesh në qetësi,  
O plep i pafrikë?

### **Poezia**

Dita ditës i shton ditë...  
Gjethja dridhet tërë frikë  
Kur nga qielli i kthen sytë;  
Poezi, ti nuk ke frikë!..

## **Fjala**

I thonë do të ikë  
Një mbrëmjeje biluri  
Tërë drithëri...  
O fjalë që s'ke frikë!..

## **Legjenda**

Përse bëhesh çikë e çikë,  
O këmishëza e butë,  
duke u endur nga pak për ditë?  
O legjenda e pafrikë!..

## **Proverba**

Shtëpi më shtëpi shëtit,  
Merr formë e shtrohet  
Ditë e për ditë  
Proverba e pafrikë...



# **Mbi kudhren time ulen zogj e rrinë**



## Poezi - kushtim

Nga një zemër që rreh janë dallgët në detet e mia,  
në gjolërat e mia;

Në det, me ujëra mbështjellë janë ato çka kam  
menduar  
në dyzimet e mia;

Në buzë të dallgëve zbresin pulëbardhat  
e ndjenjave të mia;

Detet, për mua, nga një kurorë librash  
në zemrat e mia;

Ulokëria e maunave rri e fshehur në limanin  
e të ardhmeve të mia;

Fundeve të detrave të kushtova ty, o vjershë  
e synimeve të mia!..

## Shtatënjakeri

Pasditet i lashë të ngrohen nën diell  
se pa shpatë, paqësore e shtuna vjen;

prej gurësh qumësht të bardhë dita e diel...

Atllarët i lëshova të pafre, të lirë  
se e diela për në Yskydar është një derë  
për cilindo shok që kërkon ta çelë...

Plumba nëpër ujërat që rrjedhin me vrap  
se e marta sërish dikujt ka për t'i rënë në qafë;  
për dikë tjetër - shtrat me tallash të trashë...

Shëtitjet të mërkurave i ndërpres  
se më duket se e teprova me shëtitje  
dhe se prej kodoshëve te fabrik' e letrës s'më vjen  
oreks...

Lavjerësi vazhdon të lëkundet, s'ka pushuar  
se e enjtja vazhdon, ende s'ka mbaruar;  
s'ka mbaruar tenda e saj e verdhë si në të jeshiluar...

Dhe vjen e premtja! Sapo zbardh agimi,  
ajo e bën njeriun tjetër njeri!  
Dhe njeriu e nis atë ditë jetën përsëpari...



## Mbi kudhrën time ulen zogj e rrinë

Mbi kudhër më ulen zogj e rrinë herë pas herë:  
janë në histori humnerë...

Gëzimi mundimdashës belthyer rëndon:  
mbi kudhër djers' e ballit pikon...

Kohë e fundit me ndërprerje na afron:  
humnera dyshimi u thonë...

Gjoksi më zgjerohet kohë më kohë më fort:  
besimi në një Zot...

Mbi kudhër pesë zogj ngrihen e ulen përsëri:  
pesë kohë lutje, pendesë, mirësi...

Një rrëke pikash loti mbi çekiçin rend:  
krahët e tyre - një çast transparent...

## Ka për t'u shthurur

Detet - me alga veshur, nga një insekt,  
kanë për t'u veshur me argjend...

Njerëzit grumbullohen në zemrën time sa më s'ka,  
kanë për t'u përqeshur me hahaha!..

Një plak me llullën e zhurmshme në breg shëtit,  
ka për t'i parë dhe ca ditë...

Zogjtë e detit qajnë për vetminë time,  
kanë për t'u bërë tregime...

Ujërat e para poshtë janë një qiell i lëmuar,  
ka për t'u thënë janë lëshuar...

Dhe sikur të të bëj ty kurorë me gjethe rrushi  
thurur,  
prapë ka për t'u shthurur...

## Njerëz - ushtarë

Dikush me veshje blu, tymin për dore e ka ngjitur;  
tymi i varet që ta pijë...

Ulur mbi libër qafëpërkulur një mëndjetrashë e i  
paditur;  
e mbyll fjalorin: aty le të rrijë!..

Një kolonel, kodra pas bregu flet duke bërtitur;  
e mbulon hoben që të vonojë...

Një komandant e pyet armën përse është përgatitur;  
zemra ia do që të pushojë...

Një pilot, avionin pikiatë e ka lëshuar, qiejve e ka  
ngritur  
aq sa për uljen s'ka mundur të mendojë...

Një e dy e e bën shtabin të shohë nga qielli i  
nemitur;  
rregulli e gropos njeriun, të durojë...

## Vendimet e nëntorit

Nëntori na shtrohet ditëve tona, netëve  
me vendimet e marra rishmë bashkë;

Trishtim u shtohet emrave të rrugicave  
me mendimet për shtëpitë brenda bashkë;

Pemët mbledhin flokët verdhacuke mbetur prej  
vere  
me shirat që qajnë gjatë gjithë ditës bashkë;

Eh, ç'nëntore janë rrahur në havanin e këtyre  
trojeve  
me njerëz që pa pushim plakin vite bashkë;

Duart si shpatë më bëhen për të ardhmen e neve  
me vendimet që çdo vit rinohen bashkë;

Ndaj Divanit dhe pavdekshmërisë së tij përplasat  
nëntori  
me të rejat vjersha, me risitë e gjetura bashkë...

## Fytyra e përskuqur e shtatorit

### fytyra e pasme

Pemën vjeshtake q'i thonë trishtim,  
në faqe të qiellit barkqelqtë,  
në gjoksin e purpurt të tokës,  
një mijë lloj dhimbjesh e shtrojnë...

Era t'i puth sytë,  
dridhet ultësira e qelibartë,  
dy sytë-çanak gjaku  
të bahçes-qiell po qajnë...

Në ballë, shenjë embleme heraldike,  
vetullat, të modës s'vjetër, kreshtë,  
sytë me syrme të ditës shehzadé  
butë - butë se ç'vështrojnë...

Pashabahçeja qafëpërkulur,  
në zemër, dhimbje e beftë;  
fytyrën prej ndërmjetësi të shtatorit  
për ta parë cilët shkojnë?

## fytyra e pasme

Dita ikën, vera merr fund,  
Stambolli kthehet në shtator;  
me Kanllëxhanë e përskuqur,  
në një mijë forma kthehet ky Stamboll...

## Burbuqe sevdaje

*Kushtuar Atila Emre Koçit*

### I.

Zgjati degët gjer brenda vetes sonë, o vdekje,  
Hidhërimi të na zërë me ty burbuqe!..

### II.

Një kohë e krisur është, brenda më vjen vërdallë;  
Dashurinë ma verbon shkëlqimi yt, o qielli Osman!..

### III.

Në vendin më të pazë të asaj paradite trime,  
Shpatë e Osman Beut po end njeri, shtet po ngrel!..

#### IV.

Fjalët e tua, gjithë po marrëmendje djallëzore;  
Fundin, një mauzer-burbuqe kel..

#### V.

Pesë burbuqe hapin më vete sytë ndaj bote,  
Në të ditës pesë kohë më vete...

#### VI.

Një det më zgjatet gjer brenda vetes, i paqetë;  
Pulëbardhat e vjershës kthehen të trazuara, nëpër  
det...

#### VII.

Po sheh se si burbuqet e vjershës  
Janë vyshkur krejt në vargjet e pranverës...



## Duke përmendur ujin

Uji i sedeftë në ballë tek ti  
janë fjalët që këndove  
të një fëmije që mbjell poezi...

Mos është shtet ai që ngrite  
në bahçe të tradhëtisë,  
me ujë biluri që gëlltite?

Të ikurat fjalë-sorkadhe  
nëpër lumin e padijës,  
janë për herë mungesa jote...

Pel' e kuqe syfajancë  
djersën e ballit të piu;  
vdiqe duke i rënë pas...

Zemërimi qiellor i shtetit  
gjak shtron përmbi kaftanë:  
uji i kulluar i të drejtit...

Gjoksi sa kjo gjithësi  
i ujit të tokës eskimeze,  
është fëmija me emrin njeri

Kuçedra e quajtur qiell,  
gjoksin ujit ia brimon;  
atë kthjelltësi si diell!..

Në qiell shpendi yt atlas  
hapi krahët e lotoi;  
është damari yt plot gjak...

Cili gjoks i fryrë krenar  
ka dalë sheshit në këtë vjershë  
që e lidhe me zinxhirë?

Fundi i lumit është në det;  
vdekje është fundi i rrugës  
ku vrapon ti tërë një jetë...

Dhe thesari me sërmá  
është te mali i përrallave;  
shko e shko e fund nuk ka...

Një mijë pashë shtrirë në det,  
një galerë me një mijë dyer;  
Venediku është - një qytet...

Përmbi tasin tonë rëndon  
qielli i ujit zemërblu;  
hapi krahët dhe e kupton...

Zemr' e ftohtë e mermerit  
përmendore ngre në pafundësi  
me ujin e së cilës u gatove ti

Njerëzimit famë i shtove  
sa herë emrin ta kujtojmë;  
për të linde e jetove.

Sa për vjersha një mijë e një  
vlen e vlera dashuri,  
zemra që ke endur ti...

Veç vdekja në ka për ta tharë  
detn' e dhimbjes së mungesës tënde  
që s'përshkruhet dot me fjalë!

Në buzë të burimit - o,  
vjersha se ç'të meket - o,  
fryma se ç'të pritet - ol..

Ballët e hauzit ndrit  
si mermer i bardhë i larë;  
kthjelltësi e tij tërë frikë...

Pemët janë flokët e ujit  
turbulluar me smerald,  
që servire në tas të artë...

Mu në zemër të Bizantit  
trëndafilë hidhkëshin topat  
që ti sot i mbush me ujë...

Shpat' e ndritshme e tufanit  
na e nxjerr të fshehtë sheshit  
në je bir i trëndafilin...

Cila është ajo çezmë fajkoi  
e bahçes me fytyrë kombi,  
atje ku ti gjen qetësi?

Me bagllamanë trizërëshe  
historinë këndon populli  
për të cilin frutin poqe...

Kur vjen koha e këndohet  
vjersha që bën fjalë për ujin,  
fëmijëria ty të falet...

Njëqindmijë sklevër rremëtarë  
këtë zogthin tënd në mend përsjellin  
që pas rremave ke vrarë...

Për të drejtën e Zylfikarit  
puthe në ballë këtë govatë;  
për të mirat që gjen prej ujit...



*Pa shih, një periudhë historike  
para teje udhë po merr;  
duke u rrudhur e shpalosur  
drejt shesheve të qytetit dhe  
zemrës së natës,  
një histori po merr udhë e  
mbushur plot tmerr...  
Çdo çast i natës,  
me një mëndjemadhësi të zbehtë  
mbi supet,  
është kah dridhet e lëkundet  
prej frikës së ndjerë:  
buzëmbremja, për një mijë  
drithërima tmerrri është një  
derë...*

ISBN 998958199-1



9 789989 581991